

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Elementet e njohurive të  
Auditimit të Brendshëm  
Internal Audit Knowledge  
Elements**

**B1**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 29.09.2018

CONTENT / PËRMBAITJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
<b>Total</b>	100	

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

1. Cila nga këto nuk është një shembull i kostos së agjencisë?  
A. Kostoja e kërcënimit të marrjes së 'pushtetit'.  
B. Kostoja e kompensimit të menaxhimit.  
C. Kostot e vendosura nga huadhënësit (kreditorët dhe bankierët).  
D. Kostot për shkak të niveleve minimale të likuiditetit.
  
2. Sipas Nenit 404 'Vlerësimi i menaxhmentit për kontrollin e brendshëm' të Aktit të ShBA-së Sarbanes-Oxley, vlerësimi dhe pohimi i mjedisit të kontrollit të një organizate duhet të fokusohet në cilën prej këtyre?  
A. Kontrollat e integruara.  
B. Kontrollat e veçanta.  
C. Kontrollat e buta.  
D. Kontrollat e vështira.
  
3. Cila nga të mëposhtmet nuk është e vërtetë, për rolin që luan ligji në ndikimin e vlerave shoqërore?  
A. Ligji përfaqëson një etikë minimale të sjelljes.  
B. Ligji përfaqëson kodifikimin e asaj që shoqëria e konsideron të drejtë dhe të gabuar.  
C. Ligji trajton vetëm shkeljet më të mëdha të kuptimit të së drejtës dhe të gabuarës së shoqërisë.  
D. Ligji përfshin të gjitha standardet etike të sjelljes.
  
4. Në cilin nivel të legjitimitetit të korporatës i referohemi firmave të biznesit individual që arrijnë dhe ruajnë legjitimitetin duke iu përshtatur pritjeve shoqërore?  
A. Niveli makro.  
B. Niveli mikro.  
C. Niveli i ndarjes/divizionit.  
D. Niveli i departamentit.
  
5. Lidhur me investimin e ndërgjegjshëm shoqëror, koncepti i shqyrtimit shoqëror është:  
A. Duke mos u përdorur më nga firma investuese.  
B. Duke u përdorur nga disa firma në mënyrë pozitive ose në mënyrë negative.  
C. Duke mos u praktikuar në jetën reale, përveç në klasë.  
D. Një tregti midis performancës sociale dhe performancës ekonomike.
  
6. Sa i përket menaxhimit të rrezikut, Kompanitë e Sigurimit 'Captive' kombinojnë cilat nga të mëposhtmet?
  - I. Mbajtjen e rrezikut.
  - II. Transferimin e rrezikut.
  - III. Hartografin e rrezikut.
  - IV. Profilizimin e rrezikut.  
A. I dhe II.  
B. II dhe III.  
C. III dhe IV.  
D. I dhe IV.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

7. Cila nga të mëposhtmet më së miri përfaqëson analizën e plotësimit të hendekut si një mjet për menaxhimin e rrezikut?

- A. Kjo analizë përcakton dallimin në mes të rezultatit aktual dhe rezultatit të pritshëm.
- B. Kjo analizë përdoret për menaxhimin e pasigurisë, pasi që ajo mund të ndahet në analizën e vendimeve sekuenciale dhe teorinë e investimeve të pakthyeshme.
- C. Kjo analizë merret me të dhëna sasiore në terma të valutave dhe treguesve.
- D. Kjo analizë përfshin caktimin e peshave në përgjigjet ndaj pyetjeve që adresojnë fushat që mund të shfaqin elemente të rrezikut.

8. Cila nga të mëposhtmet përcakton marrëdhënien midis të ardhurave dhe kostove?

- A. Mbrojtja natyrore.
- B. Mbrojtja e përkryer.
- C. Mbrojtja e Korporatave.
- D. Mbrojtja e krijuar nga vet Aksionerët.

9. Nga pikëpamja e menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjes, proceset e kontrollit implementohen në cilën nga të mëposhtmet?

- A. Vlerësimin e rrezikut.
- B. Zbutjen e rrezikut.
- C. Financimin e rrezikut.
- D. Monitorimin e rrezikut.

10. Dy qasjet e gjera për t'u marrë me menaxhimin e rrezikut janë:

- A. Mbrojtja e rrezikut dhe transferimi i rrezikut.
- B. Shmangia e rrezikut dhe transferimi i riskut.
- C. Shmangia e rrezikut dhe zvogëlimi i rrezikut.
- D. Kontrolli i rrezikut dhe financimi i rrezikut.

11. Cila prej kornizave të menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjes (ERM) të paraqitura më poshtë e adreson rrezikun e tregut?

- A. Rreziqet strategjike.
- B. Rreziku operacional.
- C. Rreziqet financiare.
- D. Rreziqet hazarde.

12. Cila nga këta është më i mirë për të menaxhuar programin e menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjes në aspektin e gjerë?

- A. Zyrtari kryesor i rrezikut.
- B. Bordi i Drejtorëve.
- C. Zyrtari kryesor financiar.
- D. Zyrtari kryesor i qeverisjes.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

13. Një kompani e madhe hapësinore është e organizuar në atë mënyrë që linjat vertikale dhe horizontale të autoritetit janë të kombinuara. Sipas kompanisë, kjo strukturë organizative është më e favorshme për përfundimin e projekteve të mëdha. Zgjidhni formën organizative të përdorur nga kjo kompani:

- A. Linja dhe stafi.
- B. Matricë.**
- C. Funksionale.
- D. Burokratike.

14. Cila nga deklaratat e mëposhtme më së miri përshkruan qasjen kontingjente në zgjedhjen e një strukture organizative?

- A. Organizatat më efikase dhe më efektive kanë një strukturë hierarkike të bazuar në një autoritet formal të legalizuar.
- B. Çelësi për një strukturë të suksesshme organizative është përshtatshmëria e saj me strategjinë dhe mjedisin e saj të brendshëm dhe të jashtëm.**
- C. Një strukturë e suksesshme organizative ka dy objektiva: efektivitetin ekonomik dhe kënaqshmërinë e punonjësve.
- D. Njerëzit diferencohen më pak vertikalisht sipas kategorisë dhe më shumë sipas kontributit aktual.

15. Ristrukturimi organizativ është kryer me sukses me ndërtimin e Njësive Strategjike të Biznesit (NjSB/SBUs). Cila nga të mëposhtmet nuk është kriter që një njësi organizative të kualifikohet si NjSB/SBU? Një Njësi Strategjike e Biznesit duhet:

- A. T'i shërbejë një tregu specifik jashtë organizatës prind.
- B. Të jet një qendër fitimi.
- C. Të jet e prirur për rrezik.**
- D. Të ballafaqohet me konkurrencën e jashtme.

16. Cila nga të mëposhtmet përfshin dhënien e autoritetit vendimmarrës, punonjësve të nivelit më të ulët?

- A. Decentralizimi.**
- B. Shpërndarja.
- C. Centralizimi.
- D. Departamentalizimi.

17. Për derisa promovimet e çmimeve rriten me kalimin e kohës, konsumatorët:

- A. Ndërrojnë markat për konsistencë.
- B. Bëhen më të ndjeshëm ndaj reklamimit.
- C. Bëhen më të ndjeshëm ndaj çmimit.**
- D. Gjejn alternativa me vlerë më të ulët.

18. Cila nga të mëposhtmet nuk është e vërtetë në lidhje me analizën e vlerës?

- A. Ajo shiqon mënyrat për të përmirësuar produktet.
- B. Është një qasje për uljen e kostove.
- C. Vlerëson mënyrën më efikase për të kryer një funksion.
- D. Ajo tregon mënyrën e eliminimit dhe ri-inxhinierisë.**

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

19. Masat e shërbimit si pjesë e performancës së furnitorit nuk përfshijnë cilën nga të mëposhtmet?  
A. Disponueshmërinë e produktit brenda afatit kohor të caktuar.  
B. Saktësinë e faturës.  
C. Gjatësinë e kohës së nevojshme për të zgjidhur pretendimet.  
D. Disponueshmërinë e një plani të furnizimit nga furnitori.
20. Në lidhje me teorinë e kufizimeve (Theory Of Constraints) në operacione, cila nga këto nuk do të përshkruajë një situatë të 'fytit të ngushtë' në mënyrë të përshtatshme?  
A. Ekziston një makinë ku punët përpunohen në një normë më të ngadaltë se sa që ato janë duke u kërkuar.  
B. Ekziston një qendër e punës ku punët përpunohen në një normë më të ngadaltë se sa që ato janë duke u kërkuar.  
C. Nivelet e aftësive të një punonjësi janë më të mëdha se ato të nevojshme për një punë të caktuar, por më të ulëta se ato të nevojshme për çdo punë të përgjithshme.  
D. Kërkesa për produktin e kompanisë tejkalon aftësitë e saj për të prodhuar këtë produkt.
21. Cila nga këto nuk është një nga fushat e teorisë së kufizimeve (Theory Of Constraints)?  
A. Menaxhimi i 'fytëve të ngushta'.  
B. Logjistika.  
C. Matja e performancës.  
D. Të menduarit logjik.
22. Auditorët veprojnë në organizata në të cilat menaxhmenti është në proces të ri-inxhinierimit me theks të veçantë në teknikat e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë. Në përpjekjen e tyre për të rritur efikasitetin në përpunim, shumë nga procedurat tradicionale të kontrollit janë duke u fshirë nga struktura e kontrollit të organizatës. Si pjesë e këtij ndryshimi, menaxhmenti është:  
A. Duke vendosur theks më të lartë në monitorimin e aktiviteteve të kontrollit.  
B. Duke bërë supozime të ndryshme mbi performancën njerëzore dhe natyrën e motivimit njerëzor për dallim prej asaj që ishte bërë sipas teknikave tradicionale të kontrollit.  
C. Duke vendosur theks më të lartë në vetë-korrigjimin e aktiviteteve të kontrollit dhe automatizimin e procesit.  
D. Duke bërë të gjitha të mësipërmet.
23. Cila nga mediumet e mëposhtme ka vlerën/pasurinë më të ulët të kanaleve të komunikimit?  
A. Bisedat telefonike.  
B. Komunikimet ballë për ballë.  
C. Video konferenca.  
D. Tabelat e shpalljeve.
24. Cili është qëllimi përfundimtar i aksionerëve dhe investitorëve të korporatës?  
A. Zgjedhja e kandidatëve më të mirë në bordin e drejtorëve.  
B. Rritja e vlerës së aksionerëve dhe investitorëve.  
C. Zgjedhja e kandidatit më të mirë si Drejtor Ekzekutiv.  
D. Përmirësimi i komunikimit me Bordin dhe Drejtorin Ekzekutiv.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

25. Një avantazh konkurrues që nuk mund të kopjohet lehtë ose shpejt nga konkurrentët në afat të shkurtër quhet:

- A. Pariteti konkurrues.
- B. Avantazhi i diferencuar.
- C. Avantazhi krahasues.
- D. Avantazhi i qëndrueshëm konkurrues.

26. Një sistem i kontrollit strategjik i ndihmon menaxherët të vlerësojnë rëndësinë e strategjisë së organizatës:

- A. Në lidhje me strategjinë e konkurrentëve të saj.
- B. Në lidhje me përfitueshmërin e saj.
- C. Në lidhje me progresin e saj në përmbushjen e qëllimeve të saj.
- D. Nevojat e punonjësve të saj.

27. Parashikimet e gjykimit janë:

- A. Të shpejtë dhe të shtrenjta.
- B. Të ngadalshëm dhe të lira.
- C. Të shpejtë dhe të lira.
- D. Të besueshme dhe të sakta.

28. Një kompani kohët e fundit ka prezantuar menaxhimin total të cilësisë (Total Quality Management). Drejtori i auditimit të brendshëm është përballur me përcaktimin e një qasjeje të re dhe inovative për auditimin në këtë mjedis të ri. Drejtori duhet të:

- A. Kërkojë izolim nga të gjitha shpërqëndrimet, në mënyrë që të e shqyrtojë problemin.
- B. Thërrasë ekipin e auditimit për një takim së bashku për të bërë brainstorming të ideve.
- C. Mbështetet tek mbikëqyrësi i auditimit për të zhvilluar një qasje të re.
- D. Përdorë një qasje të disiplinuar për zgjidhjen e problemeve.

29. Cila nga këto është një shpërblim i jashtëm?

- A. Vetë-aktualizimi.
- B. Vetë-besim.
- C. Lavdërime nga një menaxher i lartë.
- D. Ndjenja e arritjes.

30. Në menaxhimin e projekteve, cila nga të mëposhtmet llogarit diferencën midis vlerës kumulative të fituar të punës së kryer dhe kostos aktuale kumulative?

- A. Indeksi i performancës së kostos.
- B. Mospërputhja e kostos.
- C. Kostot e buxhetuara.
- D. Indeksi i cilësisë së kostos.

31. Cila nga këto është sfidë kritike në zbatimin e parimit të fuqizimit të punonjësit?

- A. Shtyrja e autoritet poshtë tek punonjësit e vijës së frontit.
- B. Pritja për llogaridhënie nga të gjithë të punësuarit.
- C. Delegimi i punonjësve me kufizime për të arritur objektivat.
- D. Zhvillimi i përshkrimeve të qarta dhe të plota të punës për punonjësit.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

32. Nga pikëpamja e kontrollit të qasjes, ndarja e detyrës është e dy llojeve: statike dhe dinamike. Cilat nga këto është shembull i ndarjes statike të detyrave?

- I. Kontrolli i qasjes i bazuar në role.
- II. Politika e punës.
- III. Kontrolli i qasjes i bazuar në rregulla.
- IV. Politika kineze Wall.

A. I dhe II.

B. I dhe III.

C. II dhe IV.

D. III dhe IV.

33. Një ripërdorim i fjalëkalimit të sistemit operativ të përdoruesit për autentikimin paraprak nuk duhet të praktikohet në vendosjen e cilit prej produkteve të mëposhtme të autentikimit të enkriptimit të deponimit?

A. Kodimi me disk të plotë.

B. Kodimi i vëllimit.

C. Kodimi i diskut virtual.

D. Kodimi i dosjeve dhe / ose kodimi i direktorimeve.

34. Cila nga çështjet e mëposhtme lidhet ngushtë me kontrollet logjike të qasjes?

A. Çështjet e punonjësve.

B. Çështjet e harduerit.

C. Çështjet e sistemit operativ të softuerëve.

D. Çështjet e zbatimit të softuerëve.

35. Nënshkrimi digjital implementohet duke përdorur cilën nga teknikat e mëposhtme kriptografike?

A. Kriptografia me çelës publik.

B. Kriptografia kryesore e ruajtjes.

C. Kriptografia kyçe sekrete.

D. Sistemet kriptografike hibride.

36. Për të zbutur rreziqet e përdorimit të përmbajtjes aktive, cila nga të mëposhtmet është një shembull i një mase mbrojtëse teknike?

A. Virtualizim.

B. Izolimi komponentët e programit të pronarit.

C. Kodi i mbajtjes së dëshmisë.

D. Izolimi i programeve të kufizuara.



**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

37. Një kompani kohët e fundit ka instaluar një sistem të ri të llogarive të pagueshme, që bazohet në kompjuter personal (PC). Gjashtë PC janë të lidhur në rrjet dhe kanë akses në kompjuterin kryesor ku është sistemi i bazës së të dhënave të llogarive të pagueshme. Pas kyçjes në sistem, një pjesë e bazës së të dhënave mund të shkarkohet në rrjetin e përdoruesit. Të dhënat e regjistruara dhe programet e editimit janë rezidente në rrjet dhe mund të shkarkohen në PC individuale për ekzekutim. Cila nga kontrollet e mëposhtme do të ishte e përshtatshme për të siguruar që informacioni i llogarive të pagueshme nuk është hequr nga sistemi pa miratim?

- A. Validimi i fjalëkalimeve gjatë kyçjes në sistem.
- B. Kodimi i të dhënave duhet të përdoret në nivelin e PC-ve.
- C. Softueri i kontrollit të qasjes në dosjen e të dhënave është instaluar në të dyja: në rrjet dhe kompjuterin kryesor.
- D. Çelësi kyç për t'u shfrytëzuar në PC.

38. Detyrat e caktuara siç duhet tek një zyrtar i sigurisë së informacionit mund të përfshijnë të gjitha këto, përveç:

- A. Zhvillimit të një politike të sigurisë së informacionit për organizatën.
- B. Ruajtjes dhe përditësimit të listës së fjalëkalimeve të përdoruesit.
- C. Komentimit për kontrollet e sigurisë në aplikacionet e reja.
- D. Monitorimit dhe hetimit të përpjekjeve të pasuksesshme të qasjes.

39. Kontrolli efektiv arrihet kur kontrolli menaxhues i konfigurimit është vendosur përpara fillimit të cilës prej të mëposhtmeve?

- A. Analiza e kërkesave.
- B. Dizajni.
- C. Kodimi.
- D. Testimi.

40. Cila nga të mëposhtmet është më pak e dobishme për një regjistër testimi të një aplikacioni softuerik?

- A. Regjistrimi i veprimeve për zgjidhjen e problemeve.
- B. Gjurmimi i ngjarjeve në bazë të një testimit të mëpasshëm.
- C. Raportimi i problemeve për pajtueshmërinë me një politikë.
- D. Promovimi i llogaridhënies së testuesit.

41. Cila nga mjetet e mëposhtme është më e dobishme në zbulimin e ndërhyrjeve të sigurisë?

- A. Mjetet e nxjerrjes së të dhënave.
- B. Mjetet e optimizimit të të dhënave.
- C. Mjetet e riorganizimit të të dhënave.
- D. Mjetet e qasjes në të dhëna.

42. Metodat e kontabilitetit të "përqindjes së plotësimit" dhe "plotësimit të kontratës" për projektet afatgjata të ndërtimit në proces, ndryshojnë në atë:

- A. Vetëm në metodën e përqindjes së plotësimit, faturat e progresit grumbullohen në llogarinë kundër-stoqeve të quajtura "faturimet për ndërtimin në proces."
- B. Vetëm sipas metodës së plotësimit të kontratës, kostot e akumuluarat të ndërtimit përfshihen në një llogarinë e stoqeve "ndërtimi në proces"
- C. Vetëm metoda e përqindjes së plotësimit i njeh të gjitha të ardhurat dhe fitimin bruto të kontratës kur kontrata është përfunduar.
- D. Është vetëm sipas metodës së përqindjes së plotësimit që fitimi bruto i fituar deri më tani është akumuluar në llogarinë e stoqeve "ndërtimi në proces".

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

43. Një kompani është duke e zhvlerësuar një pasuri me një jetë të dobishme pesëvjeçare. Kosto e saj 100,000€ dhe nuk ka vlerë të mbetur. Nëse përdoret metoda sipas (Lista A), shpenzimet e zhvlerësimit në vitin e dytë do të jenë sipas (Lista B).

	I	II	III	IV
Lista A	Zhvlerësimi i shumës së shifrave të viteve	Zhvlerësimi i shumës së shifrave të viteve	Zhvlerësimi i saldos zbritëse të dyfishtë	Zhvlerësimi i saldos zbritëse të dyfishtë
Lista B	20,000€	40,000€	16,000€	24,000€

- A. I.
- B. II.
- C. III.
- D. IV.**

44. Në vitet pas mesit të përdorimit të një pasurie të zhvlerësueshme, cila nga metodat e mëposhtme të zhvlerësimit do të rezultojë në shpenzimet më të larta të zhvlerësimit?

- A. Zhvlerësimi i shumës së shifrave të viteve.
- B. Zhvlerësimi i saldo zbritëse.
- C. Zhvlerësimi i saldos zbritëse të dyfishtë.
- D. Zhvlerësimi drejtvizor (linear).**

45. Një kompani amerikane dhe një kompani gjermane kanë blerë aksione të njëjta në bursën gjermane të aksioneve dhe kanë mbajtur aksionet për një vit. Nëse vlera e markës gjermane është dobësuar kundrejt dollarit amerikan gjatë periudhës, në krahasim me kthimin e kompanisë gjermane, kthimi i kompanisë amerikane do të jetë:

- A. I ulët.**
- B. I lartë.
- C. I njejtë.
- D. I pa përcaktuar nga informacioni i dhënë.

46. Cila nga skenarët e mëposhtëm do të inkurajojë një kompani që të përdorë kreditë afatshkurtra për të shlyer obligacionet e saj dhjetëvjeçare që kanë pesë vjet deri në maturim?

- A. Kompania pret që normat e interesit do të rriten gjatë pesë viteve të ardhshme.
- B. Normat e interesit janë rritur gjatë pesë viteve të fundit.
- C. Normat e interesit kanë rënë gjatë pesë viteve të fundit.**
- D. Kompania po përjeton probleme me rrjedhën e parasë së gatshme.

47. Nëse një kompani po përjetonte probleme të rrjedhës së parasë së gatshme, ajo mund të provojë një riorganizim që do të përfshinte:

- A. Një shkurtim të maturitetit të borxhit ekzistues.
- B. Zëvendësimi i disa prej borxheve të papaguara me aksione të zakonshme.**
- C. Zëvendësimi i disa prej aksioneve të zakonshme të papaguara me borxhe.
- D. Zëvendësimi i disa prej borxheve të papaguara me aksione të preferuara.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** Nga 2 pikë secila

48. Një kompani, bilanci i gjendjes i së cilës është paraqitur në Tabelën A, ka pasur rezultatet e mëposhtme të pasqyrës së të ardhurave për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2012:

Shitjet	15,000,000€
Kosto e mallit të shitur	11,500,000€
Fitimi operativ	1,750,000€
Fitimi neto	1,000,000€

Kompania ka 175,000 aksione të aksioneve të zakonshme të papaguara.

**Tabela A – Bilanci i gjendjes 2012**

<b>Pasuritë</b>	'000
Paraja e gatshme	450€
Aksionet e zakonshme të arkëtueshme	50€
Llogaritë e Arkëtueshme	650€
Stoqet	1,350€
Total pasuritë qarkulluese	
Prona, Impiante dhe Pajisje	7,000€
Minus : Zhvlerësimi	(2,000€)
PIP Neto	5,000€
Zëri i mirë	500€
<b>Total Pasuritë</b>	<b>8,000€</b>
<b>Detyrimet dhe ekuiteti</b>	
Llogaritë e pagueshme	250€
Notat e pagueshme	550€
Pagat e pagueshme	100€
Tatimi i pagueshëm	200€
<b>Total detyrimet afatshkurtëra</b>	<b>1,100€</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>	<b>3,500€</b>
Aksionet e zakonshme	1,000€
Kapitali shtesë i paguar	900€
Fitimet e mbajtura	1,500€
<b>Total ekuiteti</b>	<b>3,400€</b>
<b>Total detyrimet dhe ekuiteti</b>	<b>8,000€</b>

Bazuar në informatat në dispozicion, kthimi i kompanisë në pasuritë operative është:

- A. 21.88%.
- B. 35%.
- C. 23.33%.**
- D. 12.5%.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

49. Cila nga të mëposhtmet reflekton një preferencë kulturore për bashkëpunim, vendimmarrje në grup dhe cilësi të jetës?

- A. Kolektivizëm.
- B. Feminiteti.**
- C. Individualizëm.
- D. Mashkullorësi.

50. Koncepti i pikës së elasticitetit të reklamave zbulon:

- A. Ndryshimin në përqindje të kërkesës pas një ndryshimi në reklamim.**
- B. Ndryshimin në përqindje në sasinë e kërkuar pas një ndryshimi në reklamim.
- C. Ndryshimin në përqindje në reklamat pas një ndryshimi në sasinë e kërkuar.
- D. Ndryshimin në përqindje në reklamat pas ndryshimit të kërkesës.

**Fletë për ushtrime – mos i paraqitni zgjidhjet këtu!**